



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:245985

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05859457

Ac.nr.9426/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Y.P., nga Prishtina, të cilin e përfaqëson i autorizuari E.A., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës P.C.B., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari F.L., avokat në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensim pagave, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.830/16, të datës 05.03.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit Y.P., nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.830/16, i datës 05.03.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.830/16, të datës 05.03.2020, ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Y.P. nga Prishtina me të cilën ka kërkuar nga Gjykata që të detyrohet e paditura P.C.B., me seli në Prishtinë që në afat prej 7 ditë nga dorëzimi i aktgjykimit, në emër të dëmit material për shkak të mosrealizimit të ardhurave personale për periudhën duke filluar prej datës 03.08.2013 deri me datën 30.03.2016, t'ia paguaj shumën ashtu siç do të precizohet pas nxjerrjes së ekspertizës me kamatë ligjore prej 8%, filluar nga arritja e çdo page mujore për pagesë e deri te pagesa e plotë dhe brenda të njëjtit afat të kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, SI E PA BAZUAR. II. DETYROHET paditësi Y.P. nga Prishtina që të paditurës P.C.B., me seli në Prishtinë, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 488.00 €, në afat prej 15 ditëve nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo

jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe vendimit për kompensimin e procedurës kontestimore, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ta ndryshon aktgjykimin e goditur C.nr.830/16, datë 05.03.2020, dhe kërkesëpadia e paditësit të miratohet si e bazuar, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore e cila është specifikuar në seancën e shqyrtimit kryesor, duke i shtuar shpenzimet e përpilimit të ankesës në shumë prej 416.00 euro, dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 31.00 euro, ose aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

E paditura përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që të refuzoj ankesën e paditësit në tërësi si të pabazuar dhe të vërtetoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës C.nr.830/16.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 14.04.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurës, për shpërblimin e dëmit për shkak të mosrealizimit të të ardhurave personale. Në padi ka parashtruar se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2072/11 të datës 18.10.2013, i cili është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.954/14 të datës 20.01.2016, është miratuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës P.C.B., Ref.nr.11/286 i datës 17.08.2011, me të cilin paditësit i është ndërprerë kontrata e punës me vendimin Reg.nr.09-1141 të datës 09.09.2011. Në vazhdim, me aktgjykimin e njëjtë, e paditura është detyruar që paditësin ta kthej në vendin e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe është detyruar që paditësit në emër të dëmit material për periudhën duke filluar prej datës 18.08.2011 e deri me datë 02.08.2013, t'ia paguaj shumën prej 28,695 € me kamatë ligjore. Më tej, ka theksuar se e paditura ka përmbushur në mënyrë vullnetare obligimin ndaj paditësit, ashtu që paditësin e ka kthyer në vendin e punës dhe detyrat e punës, duke filluar nga data 03.03.2016, si dhe ia ka shpërblyer dëmin në lartësinë e gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të formës së prerë. Mirëpo, e paditura nuk i'a ka paguar paditësit dëmin material për shkak të mosrealizimit të ardhurave personale duke filluar prej datës 03.08.2013 e deri me datën 03.03.2016, në shumën që do të vërtetohet me ekspertizë financiare. I ka propozuar gjykatës që të miratohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar si në petitum të padisë, duke detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.830/16, të datës 05.03.2020, me të cilën e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar së me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr 2072/11 të datës 18.10.2013 (i formës së prerë nga data 20.01.2016), gjykata ka vërtetuar se e paditura ishte detyruar të që paditësin ta kthej në punë dhe detyra të punës së udhëheqësit të njëjesisë për administrimin e kredive me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, si dhe në emër të dëmit material i cili konsiston në humbjen e fitimit për periudhën prej datës 18.08.2011 e deri me 02.08.2013 t'ia paguaj në emër të pagave të papaguara neto shumë prej 28,695.00 €, me kamatë ligjore. Nga procesverbali i datës 03.03.2016, gjykata ka vërtetuar se palët ndërgjyqëse pas pranimit të aktgjykimit të formës së prerë kanë mbajtur takim për të diskutuar detajet e kthimit në punë. Me këtë rast e paditura e kishte njoftuar tani paditësin se brenda afatit ligjor i ka përmbushur të gjitha detyrimet për kompensimin e dëmit material sipas aktgjykimit. Tutje nga Marrëveshja për ndërprerjen e Kontratës së punës e datës 24.06.2011, me numër referencës 16/121 të datës 16.03.2016, e vërtetuar me numrin Nr.LRP 1886/2016, gjykata ka vërtetuar se sipas kërkesës së parashtruar nga paditësi për ndërprerjen e kontratës së punës të datës 14.03.2016, palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje sipas së cilës është ndërprerë Kontrata e Punës e lidhur me datën 24.06.2011, midis punëdhënësit (tani të paditurës) dhe punëmarrësit (tani paditësit) me efekt nga data 16.03.2016. Sipas së njëjtës, palët janë dakorduar që në ditën e ndërprerjes paditësi do të përfitonte: i) pagën prej datës 03.03.2016, pra nga dita kur është kthyer në punë bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr 2072/11 e deri me datën 16.03.2016; ii) kompensimin e rënë dakord me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes në shumë bruto prej 18,000.00 €; dhe iii) pagesën për ditët e pashfrytëzuara të pushimit (si në nenin 2 të saj). Gjykata, ka gjetur se sipas nenit 3 të Marrëveshjes të datës 16.03.2016: “Punëmarrësi ka pranuar se pagesa sipas nenit 2 më lartë (të Marrëveshjes) është pagesa e plotë dhe zgjidhja përfundimtare e ndërprerjes së kontratës së punësimit dhe heq dorë nga çfarëdo kërkesë që ai mund të ketë kundër punëdhënësit, qoftë ligjore ose në formë tjetër, për kompensim të dëmit apo ndonjë kompensim që del nga punësimi i tij me punëdhënësin ose nga ndërprerja e punësimit të tij”. Më tej, me nenin 4 të të njëjtës: “Punëmarrësi deklaron dhe garanton se nuk do të iniciojë kërkesa, ankesa qoftë të brendshme apo të jashtme që lidhen me faktet apo çështjet që janë rezultat i punësimit apo ndërprerjes së punësimit të tij me punëdhënësin.” Ndërsa, sipas nenit 5 të Marrëveshjes: “Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje palët deklarojnë se në lidhje me marrëdhënien e punës palët nuk kanë asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm dhe lirojnë njëra tjetrën nga të gjitha veprimet, shkaqet e veprimeve, paditë, borxhet, kërkesat, marrëveshjet, ankesat, kontratat, dhe detyrimet të ngritura në çfarëdo mënyre, direkte apo indirekte, që rrjedhin nga apo lidhur me kontratën e punës të lidhur në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit.”

Sipas konstatimit të gjykatës së shkallës së parë nga kjo shihet se paditësi ka nënshkruar marrëveshjen për ndërprerjen e kontratës së punës dhe në kundër shpërblim për pagesat, si në vijim: i) për pagën nga data 03.03.2016 e deri me 16.03.2016, ii) e shumë prej 18,000.00 € si dhe iii) për ditët e pashfrytëzuara të pushimit, i njëjti ka hequr dorë nga çfarëdo kërkesë që ka

mundur të ketë kundër punëdhënësit qoftë ligjore apo formë tjetër, për kompensim të dëmit apo ndonjë kompensim që rrjedh nga punësimi i tij me punëdhënësin ose nga ndërprerja e punësimit të tij. Më tej, i njëjti ka garantuar se nuk do të inicioj veç tjerash as ndonjë kërkesë që lidhen me faktet apo çështjet që janë rezultat i punësimit apo ndërprerjes së punësimit të tij me punëdhënësin. E po ashtu, në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes ka deklaruar se në lidhje me marrëdhënien e punës nuk ka asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm, si dhe e ka liruar të paditurën nga të gjitha veprimet, paditë, borxhet, apo kërkesë [...] dhe detyrimet të ngritura në çfarëdo mënyre, qoftë direkte apo indirekte, e që ka të bëjë me apo lidhur me kontratën e tij të punës. Si i tillë, ai edhe pse nuk është thënë shprehimisht ka hequr dorë edhe nga kërkesa për kompensimin e shpërblimit të dëmit, e cila është edhe objekt i këtij shqyrtimi.

Gjykata ka konstatuar së paditësi nuk ka arritur t'i arsyetoj pretendimet e tij, se shpërblimi prej 18,000.00 €, ka të bëjë me shpërblimin për pagat që do t'i realizonte ai në të ardhmen në një periudhë 1 vjeçare nëse do të mbetej në punë. Kjo pasi që askund në marrëveshje nuk përmendet se për çfarë periudhe ka të bëjë shuma e dakorduar prej 18,000 €. Me nenin 68 paragrafit 3 të Ligjit të Punës lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës me marrëveshje mes punëmarrësit dhe punëdhënësit, parashihet se: në rast të ndërprerjes së Kontratës së Punës me marrëveshje, punëdhënësi është i obliguar t'i paguajë të punësuarit pagën, për ditët e punës deri në ndërprerje. Ndërkaq, nuk parashihet ndonjë pagesë për të ardhmen, e të cilës i referohet paditësi. Tutje gjykata ka arsyetuar së paditësi ka pretenduar se kërkesën e tij e ka bazuar në nenin 12 të Marrëveshjes në të cilin thuhet se: "Pa marrë parasysh të lartcekurat palët janë dakorduar se secila prej tyre ka të drejtë të ndërmarrë veprime ligjore lidhur me Aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2072/11 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.954/2014." Sipas vlerësimit të gjykatës ky nen ka paraparë të drejtën e palëve për të atakuar aktgjykimet e lartcekura. Një të drejtë të tillë e ka shfrytëzuar e paditura, kur ka ushtruar revizion ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Mirëpo, në rastin konkret, paditësi ka parashtruar një kërkesë të re për shpërblimin e dëmit, e të cilën sipas vlerësimit të Gjykatës nuk mund ta bazoj vetëm në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, kjo për shkak se këtë e kufizon marrëveshja mes palëve e arritur pas nxjerrjes së aktgjykimit në fjalë. Lidhur me shpenzimet procedurale ka vendosur duke u bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë pretendimet tjera ankimore të parashtruara nga pala paditëse me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për

themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë rast nuk qëndrojnë pretendimet ankimore së në arsyetim të aktgjykimit të atakuar nuk janë treguar arsytet për faktet vendimtare dhe së arsytet e aktgjykimit janë kundërthënëse lidhur me përmbajtjen e vërtet të dokumenteve të shqyrtuara, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është i qartë dhe në të janë dhënë arsye të mjaftueshme për përmbajtjen e provave dhe vlerësimin e tyre me të cilat gjykata ka vërtetuar faktet vendimtare dhe arsyetimi është në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitën e nenit 160 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo-juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor së gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës së zhvilluar ka bërë shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1, lidhur me nenin 356 par.1, dhe 353 par.1, pika a) të LPK-së, sepse gjykata pa arsye ligjore e ka refuzuar propozimin e paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare për të caktuar lartësinë e kërkesëpadisë për shkak të mos pagimit të të ardhurave personale për periudhën kontestuese, Gjykata e Apelit, vlerëson së refuzimi i këtij propozimi nuk ka ndikuar në ligjshmërinë dhe drejtëshmërinë e aktgjykimit të atakuar, pasi që gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsytet për refuzimin e këtij propozimi, dhe së nxjerrja e kësaj prove do të ishte e nevojshme vetëm në rast së kërkesëpadia e paditësit do të ishte e bazuar, e që në rastin konkret ka rezultuar së e njëjta është e pabazuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse që kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë. Kjo për faktin se kësaj gjykate i ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, pasi që në mes palëve nuk ka qenë kontestuese fakti së e paditura duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr 2072/11 të datës 18.10.2013 (i formës së prerë nga data 20.01.2016), paditësin e ka kthyer në vendin e punës dhe i ka kompensuar pagat e papaguara neto për periudhën prej datës 18.08.2011 e deri me 02.08.2013, në shumën prej 28,695.00 €, ashtu siç ka qenë e detyruar aktgjykimin e cekur me sipër. Për më tepër, ky fakt është vërtetuar edhe në bazë të procesverbalit të datës 03.03.2016, ku palët ndërgjyqëse pas pranimit të aktgjykimit të formës së prerë kanë mbajtur takim për të diskutuar detajet e kthimit në punë, dhe me këtë rast e paditura e kishte njoftuar paditësin se brenda afatit ligjor i ka përmbushur të gjitha detyrimet për kompensimin e dëmit material sipas aktgjykimit.

Gjykata gjeti së këtu palët ndërgjyqëse pa kaluar 15 ditë nga dita kur paditësi ishte kthyer në punë teke e paditura, duke vepruar sipas kërkesës së paditësit për ndërprerje të marrëdhënies së punës me marrëveshje, me datë 16.03.2016, kanë arritur marrëveshje sipas së cilës është ndërprerë Kontrata e Punës e lidhur me datën 24.06.2011, midis punëdhënësit (tani të paditurës) dhe punëmarrësit (tani paditësit) me efekt nga data 16.03.2016. Sipas së njëjtës, palët janë dakorduar që në ditën e ndërprerjes paditësi do të përfitonte: i) pagën prej datës 03.03.2016, pra nga dita kur është kthyer në punë bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr 2072/11 e deri me datën 16.03.2016; ii) kompensimin e rënë dakord me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes në shumën bruto prej 18,000.00 €; dhe iii) pagesën për ditët e pashfrytëzuara të pushimit (si në nenin 2 të saj). Gjykata, ka gjetur se sipas nenit 3 të Marrëveshjes të datës

16.03.2016: *“Punëmarrësi ka pranuar se pagesa sipas nenit 2 më lartë (të Marrëveshjes) është pagesa e plotë dhe zgjidhja përfundimtare e ndërprerjes së kontratës së punësimit dhe heq dorë nga çfarëdo kërkesë që ai mund të ketë kundër punëdhënësit, qoftë ligjore ose në formë tjetër, për kompensim të dëmit apo ndonjë kompensim që del nga punësimi i tij me punëdhënësin ose nga ndërprerja e punësimit të tij”.* Më tej, me nenin 4 të të njëjtës: *“Punëmarrësi deklaron dhe garanton se nuk do të iniciojë kërkesa, ankesa qoftë të brendshme apo të jashtme që lidhen me faktet apo çështjet që janë rezultat i punësimit apo ndërprerjes së punësimit të tij me punëdhënësin.”* Ndërsa, sipas nenit 5 të Marrëveshjes: *“Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje palët deklarojnë se në lidhje me marrëdhënien e punës palët nuk kanë asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm dhe lirojnë njëra tjetrën nga të gjitha veprimet, shkaqet e veprimeve, paditë, borxhet, kërkesat, marrëveshjet, ankesat, kontratat, dhe detyrimet të ngritura në çfarëdo mënyre, direkte apo indirekte, që rrjedhin nga apo lidhur me kontratën e punës të lidhur në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit.”*

Gjykata e Apelit, e pranon si të ligjshëm dhe të drejtë vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë së kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit material në emër të kompensimit të të ardhurave personale për periudhën kontestuese është e pabazuar, kjo pasi që në bazë të marrëveshjes për ndërprerjen e kontratës së punës, rezulton së paditësi me pranimin e shumës së kompensimit të caktuar në marrëveshje, ka hequr dorë nga çfarëdo kërkesë që i njëjti mund të ketë pasur ndaj punëdhënësit, këtu të paditurës për kompensim të dëmit apo ndonjë kompensim që del nga punësimi i tij me punëdhënësin dhe i njëjti është pajtuar së nuk ka asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm dhe e liron të paditurën nga borxhet, kërkesat dhe detyrimet e ngritura në çfarëdo mënyre, direkte apo indirekte, që rrjedhin nga apo lidhur me kontratën e punës të lidhur në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, siç përcaktohet me decidivisht në nenin 3 dhe 5 të marrëveshjes të cekur me sipër.

Lidhur me pretendimin ankimor së gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë përmbajtjen e vërtet të procesverbalit të përpiluar me datë 03.03.2016, me rastin e kthimit të paditësit në punë ku i njëjti ka deklaruar së do të vazhdon me procedura ligjore për të kërkuar pjesën tjetër të detyrimit material përmes përbarimit, Gjykata e Apelit, vlerëson kjo deklaratë është dhënë para së palët ndërgjyqëse të nënshkruajnë marrëveshje për ndërprerjen e kontratës së punës, ku paditësi në bazë të kësaj marrëveshjeje ka hequr dorë nga çfarëdo kërkesa të tashme apo të ardhshme që ai mund të ketë ndaj të paditurës për kompensimin e dëmit apo ndonjë kompensim që del nga punësimi i tij tek e paditura. Po që se paditësi nuk ka hequr dorë nga kompensimi që i përket periudhës kontestuese ashtu siç pretendon, i njëjti nuk është dashur që të pajtohet që të heq dorë nga të gjitha kërkesat dhe të liroj të paditurën nga të gjitha borxhet që rrjedhin nga punësimi i tij siç përcaktohet me nenin 3 dhe 5 të marrëveshjes. Sipas nenit 10 të Marrëveshjes për ndërprerjen e kontratës së punës e lidhur me datë 16.03.2016, këtu palët ndërgjyqëse janë pajtuar së kjo marrëveshje paraqet marrëveshje të plotë dhe përfundimtare ndërmjet palëve dhe zëvendëson të gjitha komunikimet e mëparshme ndërmjet tyre dhe të gjitha deklaratat, përfaqësimet, kushtet dhe afatet, garancitë, autorizimet, komunikimet dhe marrëveshjet kudo që janë bërë me shkrim ose gojarisht, dhe të gjitha këto të fundit konsiderohen së janë ndërprerë më marrëveshje të ndërsjellët.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, palët ndërgjyqëse kanë lidhur marrëveshje për ndërprerjen e kontratës së punës në përputhje me nenin 68 të Ligjit të Punës ku është paraparë së “*Kontrata e Punës mund të ndërpritet me marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit. 2. Marrëveshja nga paragrafi 1. i këtij neni bëhet në formë të shkruar. 3. Në rast të ndërprerjes së Kontratës së Punës me marrëveshje, punëdhënësi është i obliguar t’i paguajë të punësuarit pagën, për ditët e punës deri në ndërprerje*”. Në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese fakti së e paditura i ka përmbushur të gjitha obligimet që dalin nga kjo marrëveshje dhe dispozita e lartcekur, ndërsa në bazë të kësaj marrëveshje rezulton së paditësi ka hequr dorë nga çfarëdo kërkesa të tashme apo të ardhshme që ai mund të ketë ndaj të paditurës për kompensimin e dëmit apo ndonjë kompensim që del nga punësimi i tij tek e paditura.

Sa i përket pretendimit së kërkesa e paditësit gjënë mbështetje në nenin 12 të Marrëveshjes për ndërprerjen e kontratës së punës, ku është paraparë së: “*Pa marrë parasysh të lartcekurat palët janë dakorduar se secila prej tyre ka të drejtë të ndërmarrë veprime ligjore lidhur me Aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2072/11 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.954/2014*”, Gjykata e Apelit, vlerëson së kjo depozitë nuk i jap të drejtë paditësit për kompensimin e pagave dhe të ardhurave tjera nga marrëdhënia e punës për periudhën kontestuese. Gjykata gjeti së në bazë të aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2072/11, të datës 18.10.2013, është anuluar si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe është detyruar e paditura që paditësin ta kthejë në punë dhe detyrat e punës si dhe t’ia paguaj pagat, kontributin pensional dhe tatimin në pagë për periudhën nga data 18.08.2011, e deri me datë 02.08.2013, që nënkupton së me këtë aktgjykim nuk është vendosur për të drejtën e paditësit për kompensimin e pagave për periudhën për të cilën tani paditësi kërkon kompensimin. Në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese së paditësi pas kthimit në punë tek e paditura nuk ka nënshkruar kontratë të re të punës por është kthyer në vendin e punës bazuar në kontratën e punës të datës 24.06.2011, e cila kontratë është ndërprerë me datë 16.03.2016, me marrëveshjen e palëve ndërgjyqëse. Nga kjo rezulton së edhe kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit material për shkak të mosrealizimit të ardhurave personale për periudhën duke filluar prej datës 03.08.2013 deri me datën 03.03.2016, bazohet në kontratën e punës të datës 24.06.2011. Duke qenë kështu, kjo gjykatë vlerëson së paditësi me nënshkrimin e marrëveshjes për ndërprerjen e kontratës së punës ka hequr dorë dhe e ka liruar të paditurën edhe nga detyrimi për pagesën e dëmit material në emër të fitimit të humbur për shkak të mosrealizimit të pagave për periudhën kontestuese. Kjo pasi që në bazë të formulimit të nenin 3 dhe 5 të Marrëveshjes në fjalë, paditësi ka hequr dorë nga çfarëdo kërkesë që i njëjti mund të ketë pasur ndaj punëdhënësit, këtu të paditurës për kompensim të dëmit apo ndonjë kompensim që del nga punësimi i tij me punëdhënësin dhe i njëjti është pajtuar së nuk ka asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm dhe e liron të paditurën nga borxhet, kërkesat dhe detyrimet e ngritura në çfarëdo mënyre, direkte apo indirekte, që rrjedhin nga apo lidhur me kontratën e punës të lidhur në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Sipas nenit 325 par.1 të LMD-së është paraparë së “*Detyrimi shuhet kur kreditori i deklaron debitorit se nuk do të kërkojë përmbushjen e tij dhe debitori të jetë dakord me këtë*, andaj me vetë faktin se paditësi në cilësinë e kreditorit ka dhënë pëlqimin se nuk ka për të kërkuar asnjë lloj kompensimi nga e paditura, konsiderohet se detyrimi është i shuar dhe si rrjedhojë kërkesa e paditësit është në tërësi e papabazuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së, përkatësisht dispozitën e nenit 452 par.1 dhe 453 të LPK-së, pasi që pala paditëse e ka humbur procesin gjyqësor, ndërsa e paditura në këtë rast ka qenë e përfaqësuar nga avokati i cili i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9426/2021, më datë 13.06.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci